

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ECO-ELB” SHA NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
I PËRPUNIMIT TË MBETJEVE URBANE, QARKU ELBASAN, ME KAPACITET
TË INSTALUAR 2850 kw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 137/11 prot., datë 20.4.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘ECO-ELB’ sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 118, datë 4.4.2023, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kw.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 5.4.2023 dhe 6.4.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 14.4.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 137/7 prot., datë 7.4.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë dhe ka vënë në dijeni Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për fillimin e procedurës si më sipër.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e kërkuar nga neni 16, “Rinovimi i licencës”; formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë së licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur); si dhe të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe pagesat e rregullimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të rregullores dhe nuk rezulton debitore ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga shoqëria “ECO-ELB” sh.a. rezulton se ai është plotësuar si vijon:

Neni 16, rinovimi i licencës, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”. Plotësuar.

- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por afati i kontratës së qirasë, të nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (qiradhënësi) dhe shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. (qiramarrësi) është deri më 27.3.2024. Në këto rrethana, ERE do të rinovojë licencën e shoqërisë në mbështetje të afateve të kësaj kontrate, për këtë arsye vlefshmëria e licencës do të jetë deri më 27.3.2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “ECO-ELB” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kw, deri më 27.3.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti